

Nr. 2749 / 16 Prot.

Durrës, më 21 . 11 .2025

V E N D I M

Nr. 152, Datë 21 . 11 .2025

P Ë R

"RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË, NGA "DOKTORATË" NË "SHKENCA EDUKIMI", PRANË UAMD-së DHE UNIVERSITETIT PEDAGOGJIK TË KRAKOVIT, POLONI, NË "DOKTORATË" NË "SHKENCA EDUKIMI" NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në zbatim të rekomandimit të dhënë nga MAS me shkresën Nr. 1066/3 Prot., datë 19.09.2025; në shkresën e Drejtuesit të Njesisë Kryesore të FE me nr. 543/7 prot., datë 07.11.2025, si dhe në relacionin Nr. 543/8 prot., datë 20.11.2025 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 21.11.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e riorganizimit mbi 20% të programit të përbashkët të studimit të ciklit të tretë, nga "Doktoratë" në "Shkenca Edukimi", pranë UAMD-së dhe Universitetit Pedagogjik të Krakovit, Poloni, në "Doktoratë" në "Shkenca Edukimi" në Universitetin

“Aleksandër Moisiu” Durrës, për vitin akademik 2026-2027, sipas materialit bashkëlidhur.

2. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën: **Shqipe**
3. Kodi i programit të studimit: **82DO0111S**
4. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

